



# **BULETINI I KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS**

Tetor 2023

# BULETINI I KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

Tetor 2023

## AKTIVITETET E KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

**(Në këtë edicion të këtij Buletini pasqyrohen  
aktivitetet për muajin tetor të vitit 2023)**

Mbahet punëtori për prezantimin e draftit të Rregullores për organizmin e brendshëm dhe funksionimin e Prokurorit të Shtetit

Prishtinë, 4 tetor 2023

Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), me mbështetjen e Programit të BE-së për Sektorin e Drejtësisë në Kosovë, EUKOJUST, ka organizuar një punëtori treditore për prezantimin e draftit të Rregullores për organizmin e brendshëm dhe funksionimin e Prokurorit të Shtetit.

Në këtë punëtori janë duke marrë pjesë Kryesuesi i KPK-së, z.Jetish Maloku, anëtarë të komisioneve, kryeprokurorë të prokurorive, prokurorë të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, përfaqësues të Ambasadës Amerikane, Zyrës së BE-së në Prishtinë dhe Projektit të EUKOJUST-it, anëtarë të grupit për hartimin e këtij drafti dhe udhëheqës administrativ të sistemit prokurorial të Kosovës.



Fillimisht, në sesionin e parë, Kryesuesi Maloku, theksoi rëndësinë e veçantë që ka ky akt nënligjor për Prokurorin e Shtetit, duke vënë në pah edhe mbështetjen e pakursyer të partnerëve ndërkombëtarë, të cilët me ekspertizat e tyre janë duke e ndihmuar në shumë segmente fuqizimin dhe avancimin e sistemit prokurorial.

Po ashtu në vijim, sipas agjendës së paraparë, është diskutuar për strukturën, detyrat dhe përgjegjësitë e Prokurorit të Shtetit, ndërsa në përfundim të sesionit të sotëm, u tha se ky draft do të trajtohet, shqyrtohet

dhe analizohet gjerësisht gjatë diskutimeve të zgjeruara të pjesëmarrësve në sesionet e radhës, sidomos për mënyrat dhe format adekuate të organizimit të punës, organizimit të administratës dhe krijimit të kushteve të nevojshme për punën e Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit (ZKPSH), Prokurorisë së Apelit (PA), Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PRSK) dhe prokurorive themelore të vendit.

### Mbahet takimi i Panelit vlerësues për intervistimin e kandidatëve për pozitën e Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjakovë

Prishtinë, 4 tetor 2023

Paneli vlerësues për pozitën e Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjakovë ka mbajtur një takim konsultativ lidhur me mbarëvajtjen e procesit të emërimit të Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjakovë.

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, njëherësh edhe Kryesuesi i Panelit, z. Jetish Maloku, njoftoi anëtarët e Panelit lidhur me mbarëvajtjen e procesit, duke theksuar se është shumë i interesuar që të ketë një proces sa më transparent.



Ndërkaq, Ushtruesja e Detyrës së Drejtoreshës së NJSHPP-së, znj. Ismije Maxhuni, njoftoi panelin me Udhëzuesit e nenit 13 dhe 14 të Rregullores 06/2019 për emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe kryeprokurorëve të prokurorive të Republikës së Kosovës, formularët e poentimit, dosjet e kompletuara - dokumentacione dhe dorëzuar nga katër kandidatët në proces, dokumentacionin e mbledhur nga institucionet e ndryshme dhe trupat e KPK-së.

Kandidatët që kanë aplikuar për pozitën e Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjakovë që kanë plotësuar kriteret dhe që do të ftohen në intervistë janë: z. Anton Hasanaj; z. Ardita Beqiraj Hyseni; z. Dëshirë Jusaj dhe z. Enis Gashi.

Këshilli Prokurorial i Kosovës do të njoftojë me kohë për procedurat e tjera të procesit të zgjedhjes së Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjakovë.

### Kryesuesi Maloku priti në takim përfaqësuesit e Projektit Rajonal "Lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit në Ballkanin Perëndimor"

Prishtinë, 9 tetor 2023

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), z. Jetish Maloku, ka pritur në takim përfaqësuesit e Projektit rajonal për monitorimin e proceseve gjyqësore, i cili implementohet nga OSBE-ja, me mbështetje të Zyrës së Bashkimit Evropian (BE) në Kosovë.



Qëllimi i takimit ishte diskutimi për intensifikimin e bashkëpunimit, në mënyrë që të avancohen edhe më tej proceset e punës me anë të mbështetjes së partnerëve ndërkombëtarë në çështjet me interes të veçantë, siç janë lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Me këtë rast, Kryesuesi Maloku, duke falënderuar përfaqësuesit e këtij projekti, theksoi nevojën e përkushtimit të dyanshëm për avancimin dhe zgjerimin e mëtejshëm të bashkëpunimit në fushën e çështjeve që kanë të bëjnë me luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit të profileve të larta në Republikën e Kosovës.

Në kuadër të bashkëpunimit të sotëm është diskutuar në lidhje me raportin e të gjeturave dhe rekomandimeve gjatë monitorimit të seancave gjyqësore dhe mënyrave se si këto rekomandime do të mund të zbatohen nga Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe institucionet e tjera të sistemit gjyqësor në Kosovë.

Në përfundim të këtij takimi, Kryesuesi i KPK-së edhe përfaqësuesit e OSBE-së dhe BE-së janë pajtuar për vazhdimin e bashkëpunimit dhe zbatimit të rekomandimeve të këtij raporti.

## Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës ka pritur në takim përfaqësuesit e Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar të Republikës së Shqipërisë

Prishtinë, 10 tetor 2023

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial i Kosovës (KPK), z. Jetish Maloku, i shoqëruar nga Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, z. Blerim Isufaj dhe anëtarët e KPK-së, z. Ardian Hajdaraj dhe z. Armend Zenelaj, ka pritur sot në takim drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar të Republikës së Shqipërisë (SPAK), z. Altin Dumani.

Qëllimi i vizitës së sotme konsiston me vendosjen e urave për fuqizimin e bashkëpunimit dypalësh në kuadër të sundimit të ligjit dhe luftës së përbashkët kundër krimin të organizuar dhe diskutimin për zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta ndërmjet institucioneve përkatëse të të dyja vendeve.

Kryesuesi i KPK-së, z. Jetish Maloku, falënderoi kreun e SPAK-ut, z. Dumani, për vizitën në institucionet e sistemit prokurorial, duke vlerësuar lart rëndësinë e takimeve të tilla dhe shkëmbimin e përvojave, me ç'rast theksoi se takimi i sotëm përbën një moment të rëndësishëm në drejtim të avancimit të partneritetit dhe zbatimit të sundimit të ligjit në Republikën e Kosovës dhe Republikën e Shqipërisë.



Bashkëbiseduesit, z. Maloku dhe z. Dumani, shprehën përkushtimin dhe zotimin e tyre për intensifikimin e mëtejshëm të bashkëpunimit, të cilat do të ndikojnë

pashmangshëm në suksesin e luftimit të tërësishëm të të gjitha llojeve të krimin.

Rrjedhimisht, në përfundim të këtij takimi, të dyja palët potencuan edhe rolin, ndihmën dhe mbështetjen e rezervë të partnerëve ndërkombëtarë të Kosovës dhe Shqipërisë në kuadër të fuqizimit të zbatimit të ligjit në të dyja vendet, si dhe proceset integruese që ndërliken më zbatimin e praktikave dhe standardeve të BE-së në fushën e drejtësisë.

## Kryesuesi Maloku: Jemi duke u angazhuar për realizimin e obligimeve tona që dalin në rrugën e integriteteve evropiane

Prishtinë, 10 tetor 2023

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), z. Jetish Maloku, zhvilloi një takim pune me Shefin e Zyrës së Bashkimit Evropian (BE) në Kosovë, z. Tomas Szunyog, me bashkëpunëtorë.

Në fokus të takimit të sotëm të z. Maloku me z. Szunyog ishte diskutimi për intensifikimin dhe thellimin e mëtejshëm të bashkëpunimit në mes të sistemit prokurorial dhe mekanizmave të Zyrës së BE-së në Kosovë lidhur me zbatimin e sundimit të ligjit dhe angazhimet e tjera me interes të përbashkët.



Me këtë rast, Kryesuesi Maloku informoi nga afër Ambasadorin Szunyog për zhvillimin e aktiviteteve që po bëhen për realizimin e obligimeve që dalin në procesin e reformës së sistemit të drejtësisë në Kosovë, të cilat kanë të bëjnë, përveç të tjerave, me fuqizimin e transparencës publike, efektivitetin, efikasitetin dhe llogaridhënien gjatë procesit të punës. Ai, tha se, në mënyrë të veçantë, sistemi prokurorial është duke u angazhuar edhe për realizimin e obligimeve që dalin në rrugën e integriteteve evropiane.

Po në këtë kontekst, shefi e BE-së në Kosovë, duke falënderuar për pritjen, theksoi gatishmërinë dhe përkushtimin e Zyrës së BE-së në Kosovë për të ofruar

ndihmën e nevojshme drejt fuqizimit të mëtejshëm të sundimit të ligjit në Kosovë.

Në takim të dy bashkëbiseduesit shprehën vlerësimin e përbashkët për rritjen e bashkëpunimit në të ardhmen.

## KPK-ja shpall konkurset për emërimin e Kryeprokurorit të Prokurorisë Speciale dhe Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë

Prishtinë, 13 tetor 2023

Këshilli i Prokurorial i Kosovës (KPK), i udhëhequr nga kryesuesi Jetish Maloku, mbajti takimin e 235-të me radhë.

Fillimisht, KPK-ja mori vendim bazuar në Rregulloren për Emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe të Kryeprokurorëve të Prokurorisë të Republikës së Kosovës, për shpalljen e konkurseve për emërimin e Kryeprokurorit të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK) dhe emërimin e Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, nga data 16 tetor deri më datën 3 nëntor 2023, si dhe themeloi panelet vlerësuese dhe komisionet përkatëse për rishqyrtim për këto dy konkurse.



Anëtarët e KPK-së vendosën për shpalljen e brendshme për avancimin e dy prokurorëve në Departamentin e Krimeve të Rënda dhe dy prokurorëve të tjerë në Departamentin për të Mitur në Prokurorinë Themelore në Prishtinë dhe miratuan Raportin për vlerësim të performancës së nëntë (9) prokurorëve me mandat të përhershëm, me ç'rast trajtoi edhe kundërshtimet e paraqitura ndaj këtij raporti, sipas ligjeve dhe rregulloreve në fuqi.

KPK-ja aprovoi kërkesën për klasifikimin e vendeve të punës dhe ndryshim-plotësimin e Planit të personelit administrativ të sistemit prokurorial për vitin 2023 dhe propozimin për dërgimin e një letre urgjente te Presidentja e vendit për dekretimin e Kryeprokurorit

të Shtetit, z.Blerim Isufaj, pas publikimit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese.

KPK-ja po ashtu aprovoi dërgimin e propozimit te Presidentja e vendit për lirim nga detyra të një prokurori të Prokurorisë Themelore në Pejë dhe të një prokurori të Prokurorisë Themelore në Prishtinë me rastin e pensionimin të tyre gjatë muajit nëntor 2023.

## Komunikatë për media e Këshillit Prokurorial të Kosovës

Prishtinë, 17 tetor 2023

Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) ka mbajtur një takim të mbyllur, në të cilin ka diskutuar për situatën e krijuar pas njoftimit të Presidentes së Kosovës, znj. Vjosa Osmani, për mosdekretimin e Kryeprokurorit të ri të Shtetit, z.Blerim Isufaj, duke shprehur mospajtim të thellë ndaj deklaratave të saj, të ndërtuara mbi një rrafsh më tepër politik sesa kushtetues dhe ligjor, me arsyetime tejet të pabazuara dhe jashtëzakonisht tendencioze, të cilat i prezantoi sot në një konferencë për media.

KPK-ja ka mbajtur publikun të informuar vazhdimisht lidhur me komunikimet zyrtare dhe shkresat e adresuara në Zyrën e Presidentes, si dhe më herët edhe lidhur me procesin e përzgjedhjes së Kryeprokurorit të Shtetit, prandaj konstatoi se, Presidentja, si garantuese e zbatimit të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në konferencën e sotme për media vërtetoi përpjekjen sistematike për shtrirjen e ndikimit politik mbi sistemin prokurorial të Republikës së Kosovës, me ç'rast lidhur me këtë çështje prezantoi arsye të paqëndrueshme për mosdekretimin e kandidatit për Kryeprokuror të Shtetit, gjë që është në kundërshtim me normat ligjore dhe kushtetuese.

Këshilli Prokurorial vlerësoi se, deklaratat e tilla publike përbëjnë ndërhyrje të drejtpërdrejtë në punën e sistemit prokurorial, përkatësisht në institucionin e Prokurorit të Shtetit.



Lidhur me deklaratat e sotme se ka pasur presione dhe kërcënime, ftojme Presidenten e vendit që nëse ka prova dhe dëshmi t'i dërgojë ato te organet

kompetente, në mënyrë që të ndriçohen plotësisht, sepse sistemi prokurorial është institucion i veçantë kushtetues, i pavarur dhe i paanshëm, i cili kryen detyrën e vet në përputhje me mandatin kushtetues dhe ligjor.

Me këtë rast, sa i përket vlerësimit të procedurës, Këshilli Prokurorial, theksoi se qëndron prapa procedurave të përzgjedhjes së Kryeprokurorit të Shtetit dhe se deklaratat e tilla, për kinse, evidentimin e të gjitha shkeljeve nga ana e KPK-së, janë në kundërshtim të hapur dhe në këtë kuptim, Presidentja e Republikës as nuk mund të emërojë ndonjë prokuror pa propozimin e Këshillit Prokurorial, por as nuk mund të refuzojë propozimin e Këshillit Prokurorial për emërimin e prokurorëve. Siç u tha më tej në këtë takim, e vetmja hapësirë ku Presidentja e Republikës, në kuptim të kompetencës në paragrafët 5, 6 dhe 7 të Nenit 109 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ku mund të veprojë është që mund të refuzojë një propozim të Këshillit Prokurorial nëse ai/ajo nuk i përmbush kushtet formale, por kurrsesi ta refuzojë atë për arsye substanciale.

Për më tepër, në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, kompetenca e Presidentes së vendit për dekretim është e lidhur vetëm me propozimin e KPK-së, i cili në mënyrë unanime ka propozuar z. Blerim Isufaj, për pozitën e Kryeprokurorit të Shtetit.

Në përfundim të këtij takimi, u tha se KPK-ja do të mbajë së shpejti një takim për të vendosur lidhur me hapat që do të ndjekë pas njoftimit të Presidentes për mosdekretimin e Kryeprokurorit të Shtetit.

## Kryesuesi Maloku priti në takim shefin e ri të EULEX-it, Giovanni Barbano

Prishtinë, 18 tetor 2023

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), Jetish Maloku, ka zhvilluar një takim me shefin e ri të EULEX-it në Kosovë, Giovanni Barbano.



Kryesuesi Maloku, falënderoi shefin e EULEX-it, Barbano, për vizitën e tij në Këshillin Prokurorial dhe e përgëzoi për mandatin e tij, duke theksuar së sistemi prokurorial është i përkushtuar për koordinim dhe bashkëpunim të vazhdueshëm me këtë mision për të garantuar fuqizimin e sundimit të ligjit në Kosovë, bazuar në praktikat dhe standardet më të mira të BE-së.

Me këtë rast, shefi i EULEX-it, shprehu falënderimin e tij për pritjen e bërë dhe gatishmërinë e misionit që udhëheq për të ofruar edhe më tutje mbështetjen dhe ndihmën e nevojshme për sistemin prokurorial, në mënyrë që të ketë angazhim të përbashkët për avancimin e sundimit të ligjit në Kosovë.

Po ashtu, gjatë takimit të sotëm, është diskutuar që sistemi prokurorial i Kosovës duhet të qëndrojë i pacenuar ndaj çfarëdolloj ndërhyrjeje politike dhe ndaj çfarëdolloj ndërhyrjeje tjetër qoftë brenda apo jashtë sistemit prokurorial, në mënyrë që të realizojë si duhet misionin e tij të pavarur, të paanshëm dhe transparent në të gjitha angazhimet e tij dhe në përputhje me mandatin ligjor dhe kushtetues.

Në kuadër të këtij takimi, për shkak të rëndësisë së bashkëpunimit në fushën e sundimit të ligjit dhe luftimit e krimit të organizuar, të dyja palët u pajtuan që të ecet më tutje në rrugën përpara dhe të ketë angazhim të shtuar për tejkalimin e sfidave për realizimin e misioneve të përcaktuara për arritjen e objektivave që ndikojnë në fuqizimin e sundimit të ligjit në Kosovë.

## Mbahet takimi i radhës i Komisionit për Buxhet, Financa dhe Personel të KPK-së

Prishtinë, 19 tetor 2023

Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel i Këshillit Prokurorial të Kosovës, i udhëhequr nga prokurorja Ariana Shajkovci, mbajti takimin e radhës, në të cilin morën pjesë anëtarët e tij, Ushtruesja e Detyrës së



Drejtoreshës së Përgjithshme të Sekretariatit të KPK-së, Shqipe Hykollli dhe udhëheqëset e njësisë administrative për buxhet dhe financa.

Qëllimi i këtij takimi ishte shqyrtimi i kërkesës buxhetore të KPK-së pas qarkores së dytë buxhetore, ngaqë me këtë qarkore kanë ndryshuar kufijtë buxhetorë në kategoritë e pagave, mëditjeve, mallrave dhe shërbimeve.

Në këtë takim është theksuar se edhe përkundër ndryshimit të kufijve buxhetorë të KPK-së përmes qarkores së dytë, prapëseprapë është e nevojshme që Kërkesa buxhetore për vitet 2024-2026 të mbetet e njëjta, kërkesë kjo, e cila është miratuar nga KPK-ja.

## Intervistohen katër kandidatë për Kryeprokuror të Prokurorisë Themelore të Gjakovës

Prishtinë, 19 tetor 2023

Këshilli Prokurorial i Kosovës ka organizuar procesin e intervistimit të kandidatëve për Kryeprokuror të Prokurorisë Themelore të Gjakovës.

Paneli Vlerësues për përzgjedhjen e Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore të Gjakovës, i cili përbëhet nga pesë anëtarë të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe kryesohet nga Kryesuesi i KPK-së, Jetish Maloku, ka intervistuar katër kandidatë që kanë aplikuar dhe janë konfirmuar për pozitën e Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore të Gjakovës.



Kandidatë për pozitën e Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore të Gjakovës janë prokurorët, si vijon: Anton Hasanaj, Ardita Beqiraj-Hyseni, Dëshirë Jusaj dhe Enis Gashi.

Procesi i intervistimit të kandidatëve për Kryeprokuror të Prokurorisë Themelore të Gjakovës është monitoruar nga përfaqësues të Ambasadës

Amerikane, Misionit për Sundim të Ligjit në Kosovë (EULEX) dhe Programit të BE-së për Sektorin e Drejtësisë në Kosovë (EUKOJUST).

Paneli Vlerësues, pas procesit të intervistimit, vlerësimit dhe arsyetimit, do t'i propozojë Këshillit Prokurorial të Kosovës për votim kandidatët e suksesshëm.

## Mbahet takimi i radhës i Komisionit për Çështje Normative të KPK-së

Prishtinë, 20 tetor 2023

Komisioni për Çështje Normative i KPK-së, i udhëhequr nga Armend Zenelaj, ka mbajtur takimin e radhës, në të cilin mori pjesë prokurori nga Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, Bahri Hyseni, Ushtruesja e Detyrës së Drejtoreshës të SKPK-së, Shqipe Hykollli dhe udhëheqës të njësisë organizative.



Qëllim i takimit të sotëm ishte shqyrtimi i komenteve të draftit të Rregullores për Organizmin e Brendshëm dhe Funkcionimin e Prokurorit të Shtetit, të cilat kanë ardhur pas punëtorisë së mbajtur, në të cilën është prezantuar në mënyrë të detajuar drafti, me ç'rast, pas analizimit të komenteve u inkorporuan ato më relevantet për strukturën, detyrat, përgjegjësitë, format e organizmit të punës dhe organizimit të administratës në institucionin e Prokurorit të Shtetit.

Anëtarët e Komisionit për Çështje Normative u pajtuan që në takimin e radhës të bëjnë finalizimin e tërësishëm të këtij drafti, si dhe të bëjnë analizimin e shtojcës së përshkrimit të detyrave të punës, shtojcë kjo, e cila do të jetë pjesë integrale e draftit të kësaj rregulloreje që do të procedohet për miratim në njërin nga takimet e KPK-së.

## Kryesuesi Maloku merr pjesë në aktivitetin e fillimit të Javës për të Drejtat e Viktimave të Krimit

Prishtinë, 23 tetor 2023

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, z.Jetish Maloku, ka marrë pjesë në aktivitetin e shënimit të fillimit të Javës për të Drejtat e Viktimave të Krimit në Kosovë, të organizuar nga Ambasada Amerikane në Kosovë, javë kjo, që zhvillohet nën përkujdesjen e Ushtruesit të Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, z.Besim Kelmendi, me ç'rast është mbajtur një tryezë diskutimi me titull: "Koordinimi ndërinstucional në luftimin e trafikimit të njerëzve".

Në këtë hapje zyrtare të Javës për të Drejtat e Viktimave të Krimit morën pjesë Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, z.Jeffrey Hovenier, Kryetari i Gjykatës Supreme, z.Fejzullah Rexhepi, Ministri e Drejtësisë znj. Albulena Haxhiu, Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, z.Albert Zogaj, përfaqësues të Policisë së Kosovës dhe Zyrës për Mbrojtjen e Viktimave.



Kryesuesi Maloku, në fjalën e tij të rastit, shprehu falënderimin e tij për mbështetjen e madhe të Ambasadës së SHBA-së në Kosovë, jo vetëm për evenimentin e sotëm të shënimit të të drejtave të viktimave të krimit në Republikën e Kosovës, por edhe në të gjitha aspektet dhe zhvillimet e tjera që kanë të bëjnë me koordinimin dhe bashkëpunimin drejt fuqizimit dhe avancimit të sistemit prokurorial në bazë të praktikave dhe standardeve më të mira ndërkombëtare.

Shënimi i kësaj Jave ka për qëllim të sensibilizimit publik për të drejtat e viktimave të krimit dhe do të përcjellët me aktivitete të shumta nëpër prokuroritë e vendit, ku janë paraparë të mbahen tryeza diskutimi me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare.

## Praktikat e ndjeshme gjinore në gjyqësor, temë e punëtorisë së Forumit të Grave Gjyqtare dhe Prokurore

Prishtinë, 27 tetor 2023

Forumi i Grave Gjyqtare dhe Prokurore, në bashkëpunim me Misionin e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) në Kosovë, organizoi një punëtori për praktikat e ndjeshme gjinore në gjyqësor.



Në këtë punëtori morën pjesë përfaqësueset e të gjitha niveleve të institucioneve gjyqësore dhe prokuroriale, përfshirë kryetaren e Forumit të Grave Gjyqtare dhe Prokurore, znj.Vlora Pacolli-Rexhepi, anëtarën e KGJK-së, znj.Teuta Ibrahim, anëtarën e KPK-së, znj.Jehona Grantolli, Prokuroren në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, znj.Sevdije Morina, përfaqësueset e gjykatave dhe prokurorive të vendit, si nga Policia e Kosovës, z.Fadil Abdyl.

Me këtë rast, kryetarja e Forumit të Grave Gjyqtare dhe Prokurore, znj. Vlora Pacolli-Rexhepi, falënderoi Misionin e OSBE-së në Kosovë për përkrahjen dhe mbështetjen e Forumit të Grave Gjyqtare dhe Prokurore të Kosovës dhe për krijimin e mundësive për fuqizimin gjinor në sistemin gjyqësor dhe prokurorial të Kosovës, të cilat kanë ndikim, jo vetëm në strukturën dhe sistemit ligjor, por edhe në vetë besimin e shoqërisë në sistemin e drejtësisë. Ndërkaq, përfaqësuesja e KGJK-së, gjyqtarja Teuta Ibrahim, theksoi se takimet e tilla do të shërbejnë si nismë e një bashkëpunimi për të fuqizuar pozitën e grave në sistemin gjyqësor dhe prokurorial në kuadër të praktikave të ndjeshme gjinore në gjyqësor.

Gjithashtu, një vëmendje e veçantë iu kushtua edhe sfidave që paraqiten në mjedisin e punës së grave gjyqtare dhe prokurore, me theks të veçantë luftimit të dhunës kibernetike ndaj grave dhe krijimit të një mjedisi mbështetës të punës për gratë gjyqtare dhe prokurore, me ç'rast paneliste ishte edhe anëtarja e Këshillit Prokurorial të Kosovës, prokuroreja Jehona



Grantolli, e cila theksoi se, të gjithë mekanizmit institucionalë të drejtësisë duhet të angazhohen maksimalisht për të arritur objektivat që fuqizojnë dhe avancojnë rolin dhe përgjegjësinë e grave në sistemin gjyqësor dhe prokurorial të Kosovës.

Gjatë zhvillimit të sesioneve të sotme është bërë thirrje për zbatimin e praktikave dhe standardeve më të mira gjinore në Gjyqësor, me qëllim të sigurimit dhe garantimit të vlerave që pasqyrojnë barazinë, pa dallim race, gjinie dhe feje, ashtu siç parashihet me Kushtetutën dhe ligjet e vendit.

Rrjedhimisht, në këtë punëtori, u tha se nisma të tilla, si kjo e sotmja, shërbejnë për të fuqizuar pozitën e grave në sistemin gjyqësor dhe prokurorial dhe ngritin efikasitetin dhe efektivitetin e drejtësisë, duke krijuar trajtimin e barabartë të gjithëve në procedurat rekrutuese pavarësisht gjinisë dhe statusit personal.

Në përmbyllje të punëtorisë është theksuar se Forumi i Grave Gjyqtare dhe Prokurore, në përbërje të të cilit janë gratë gjyqtare dhe prokurore, do të vazhdojë punën dhe angazhimin me përkushtim të madh për të fuqizuar pozitën e gruas në sistemin gjyqësor, duke garantuar barazinë gjinore, trajtimin dinjitoz dhe meritokratik.

## Finalizohet drafti i Rregullore për Organizimin e Brendshëm dhe Funkcionimin e Prokurorit të Shtetit

Prishtinë, 30 tetor 2023

Komisioni për Çështje Normative i Këshillit Prokurorial të Kosovës, i udhëhequr nga prokurori Armend Zenelaj, mbajti takimin e radhës, në të cilin morën pjesë anëtarët e këtij komisioni dhe udhëheqësit e njësisë administrative të KPK-së.



Në takimin e sotëm është bërë shqyrtimi përfundimtar i draftit të Rregullore për Organizimin e Brendshëm dhe Funkcionimin e Prokurorit të Shtetit, duke arritur gjer të finalizimi i plotë i përshkrimit të strukturës, detyrave, përgjegjësisë, formave të organizimit të

punës dhe organizimit të administratës në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, Prokurorinë e Apelit, Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës dhe prokuroritë themelore të vendit.

Gjithashtu, po në këtë takim, është bërë analizimi i dy shtojcave të përshkrimit të detyrave të punës dhe organogramit, shtojca këto, që do të jenë pjesë integrale të kësaj rregulloreje, kurse në përmbyllje, u tha që draftrregullorja do të procedohet për miratim në njëhën nga takimet e radhës së Këshillit Prokurorial.

## Kryesuesi Maloku priti në takim Shefin e Misionit të OSBE-së në Kosovë, Ambasadorin Michael Davenport

Prishtinë, 30 tetor 2023

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial (KPK), Jetish Maloku, ka pritur në takim shefin e Misionit të OSBE-së në Kosovë, Ambasadorin Michael Davenport.



Që në fillim të takimit të sotëm, Kryesuesi Maloku, falënderoi Ambasadorin Davenport për vizitën e tij, duke shprehur mirënjohjen e tij të veçantë për bashkëpunimin, kontributin dhe angazhimin e Misionit të OSBE-së në Kosovë në fushën e sundimit të ligjit.

Më këtë rast, Kryesuesi i Këshillit Prokurorial, Jetish Maloku, tha se Misioni i OSBE-së në Kosovë ishte dhe mbetet një organizatë tejet e rëndësishme në kuadër të zbatimit të objektivave strategjike të sistemit prokurorial, qoftë përmes organizimit të trajnimeve specifike dhe përmes formave të tjera profesionale dhe teknike.

Nga ana tjetër, shefi i Misionit të OSBE-së në Kosovë, Ambasadori Davenport, falënderoi kryesuesin Maloku

për pritjen, duke theksuar gatishmëria e OSBE-së për të vazhduar mbështetjen e mëtejshme për forcimin e zbatimit të ligjit dhe mbrojtjen e të drejtave të të gjithë qytetarëve në Kosovë.

Meqenëse, KPK-ja dhe Misioni i OSBE-së bashkëpunojnë përmes projekteve dhe memorandumëve të ndryshme, me qëllim të ngritjes së efikasitetit, efektivitetit, komunikimit dhe transparencës së sistemit prokurorial, z.Maloku dhe z.Davenport shprehën gatishmërinë e institucioneve që përfaqësojnë për të thelluar dhe intensifikuar bashkëpunimin drejt realizimit të të gjitha projekteve në fushën e sundimit të ligjit në Republikën e Kosovës.

## Mbahet takimi i radhës i Komisionit për Administrim të Prokurorive

Prishtinë, 31 tetor 2023

Komisioni për Administrim të Prokurorive i Këshillit Prokurorial të Kosovës, i udhëhequr nga z.Veton Shabani, ka mbajtur takimin e radhës, në të cilin morën pjesë anëtarët e këtij Komisioni, përfaqësuesit e Zyrës së BE-së dhe Këshillit të Evropës në Kosovë, si dhe udhëheqësit e njësive administrative të SKPK-së.



Në takim është diskutuar fillimisht për gjenerimin më të lehtë dhe më të qashtëm të raporteve statistikore në SMIL dhe është bërë vlerësimi i raporteve manuale të cilat hartohen nga Njësi për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë, me ç'rast u theksua nevoja e vlerësimit adekuat të tyre dhe intensifikimi i punës për thjeshtësimin e tyre për rastet, sipas praktikave dhe standardeve më të mira ndërkombëtare, me qëllim të kalimit sa më të shpejtë në raporte statistikore të gjeneruara nga SMIL-i.

Në vijim të takimit është diskutuar për detyrat e Grupit të punës së përdoruesve të SMIL-it të sistemit prokurorial lidhur me propozimet konkrete për përmirësimin e procesit të punës gjatë vendosjes së të dhënave dhe përgjithësisht për konsolidimin, zhvillimin dhe funksionalizimin e plotë të SMIL-it. Anëtarët e këtij Komisioni aprovuan listën prej 8 anëtarësh të

Grupit të punës së përdoruesve të SMIL-it, të cilën do t'ia propozojnë Këshillit Prokurorial për miratim në njërin nga takimet e ardhshme.

Po ashtu, anëtarët e Komisionit për Administrim të Prokurorive aprovuan kërkesat për avancimin e SMIL-it dhe diskutuan për pamjet informuese të këtij sistemi informativ për prokurorë lidhur me lëndët e pranuar, lëndët në punë, lëndët e zgjidhura dhe pazgjidhura, si dhe mesataren e lëndëve të zgjidhura, sipas llojit të regjistrave.